

**SONY**<sup>®</sup>

Altoparlanti horizontal

Udhëzuesi i fillimit



HT-CT370



## Konfigurimi

<b>1</b>	Çfarë ka në kuti	4
<b>2</b>	Instalimi	5
<b>3</b>	Lidhja	6
<b>4</b>	Ndezja e sistemit	8
<b>5</b>	Dëgjimi i tingujve	9


## Funksionet bazë

	Shijimi i efekteve zanore	10
	Dëgjimi i tingujve nga pajisjet BLUETOOTH	12


---

Referojuni Udhëzimeve të përdorimit që keni marrë për më shumë informacion mbi veçoritë e tjera.


# 1 Çfarë ka në kuti



Altoparlanti horizontal (1)




Nën-vuferi (1)



Telekomanda (1)




Bateri R6 (përmasa AA) (2)



Kabloja dixhitale optike e televizorit (1)



Këmbët e altoparlantit të nën-vuferit (4)



Kllapa për montim në mur (2)  
dhe vidha (2)





Udhëzuesi i fillimit (ky libër) (1)




Udhëzimet e përdorimit (1)

## Konfigurimi i telekomandës

Tërhiqni lart kapakun e baterisë dhe futni dy bateri AA sipas orientimit të treguar në figurë.



## 2 Instalimi



**Për të instaluar altoparantën horizontal në mur**  
Drejtojuni Udhëzimeve të përdorimit që keni marrë.

### Nëse preferoni...

Për të instaluar nën-vuferin vertikalisht


- Vendosni nën-vuferin në mënyrë të tillë që logoja „SONY” të jetë në anën e majtë përballë anës së përparme.



Gominat e altoparantit


# 3 Lidhja

## Lidhja me një televizor



Nëse televizori që do të lidhet nuk është i pajisur me një terminal optik për dalje audio, lidhni një kablo HDMI (nëse nuk ofrohet, të llojit me shpejtësi të lartë) me terminalin e hyrjes HDMI të etiketuar „ARC”. Nëse terminali i hyrjes HDMI i etiketuar „ARC” lidhet me një pajisje tjetër, shkëputeni atë pajisje dhe lidhni këtë altoparlant horizontal.


## Kur lidheni me një televizor dhe pajisje të tjera



Kjo është një lidhje për të shijuar me më shumë efikasitet tingullin rrethues.

- A** Kabloja HDMI (nuk jepet, e llojit me shpejtësi të lartë)  
Nëse terminali i hyrjes HDMI në televizor nuk është etiketuar „ARC“, kryeni lidhjet **A** dhe **B**.
- C** Kabloja HDMI (nuk jepet, e llojit me shpejtësi të lartë)  
Nëse është lidhur me televizorin, shkëputeni dhe lidheni me altoparlantin horizontal.


## 4 Ndezja e sistemit



- 1 Lidhni kordonët e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).
- 2 Shtypni butonin I/O (ndezur/në gatishmëri).  
Ekran ndizet.
- 3 Konfirmoni që llambushka e ndezjes/gatishmërisë e nën-vuferit të ndizet në të gjelbër. Nëse jo, transmetimi me valë nuk është aktivizuar. Referojuni pjesës „Nga nën-vuferi nuk dëgjohet tingull.“ të „Zgjidhja e problemeve“ në Udhëzimet e përdorimit që keni marrë.
- 4 Ndizni pajisjen e lidhur.



## 5 Dëgjimi i tingujve



### Dëgjimi i audios së televizorit

- 1 Shtypni butonin (hyrja) në telekomandë ose butonin INPUT në altoparlantin horizontal në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur daljen „TV”.
- 2 Shtypni butonin (volumi) në telekomandë ose butonin VOL në altoparlantin horizontal për të rregulluar volumin.


### Për të dëgjuar audion nga një pajisje hyrëse ndryshe nga televizori

Shtypni butonin (hyrja) në telekomandë ose butonin INPUT në altoparlantin horizontal në mënyrë të përsëritur derisa në ekran të shfaqet pajisja e hyrjes së dëshiruar.

TV → HDMI 1 → HDMI 2 → HDMI 3 → ANALOG → BT AU



Konfigurimi është kryer! Përdorim të mbarë!



## Shijimi i efekteve zanore

Për të vendosur një efekt zanor, shtypni një nga butonat e efektit zanor në telekomandë për të zgjedhur modalitetin e dëshiruar ndërkohë që shikoni ekranin.


<b>SOUND FIELD:</b> Efektet që i përshtaten tingullit hyrës.	<b>CLEARAUDIO+</b>	Cilësimi i përshtatshëm i tingullit zgjidhet automatikisht për burimin zanor.
	<b>STANDARD</b>	I korrespondon çdo burimi.
	<b>MOVIE</b>	Dialogu është i qartë dhe tingulli është i fuqishëm dhe realist.
	<b>SPORTS</b>	Komentimi është i qartë, brohoritjet dëgjojnë si tingull rrethues dhe tingujt janë realistë.
	<b>GAME</b>	Tingujt janë të fuqishëm dhe realistë, të përshtatshëm për videolujëra.
	<b>MUSIC</b>	Tingujt luhen për t'iu përshtatur një programi muzikor, disqeve Blu-ray, ose DVD.
	<b>P.AUDIO</b> (Audio portabël)	Tingujt luhen për t'iu përshtatur një lexuesi muzikor portabël duke përdorur DSEE*.

<b>VOICE:</b> Ndhmon në qartësimin e dialogëve.	<b>TYPE1</b>	Standard
	<b>TYPE2</b>	Theksohet gama e dialogut.
	<b>TYPE3</b>	Theksohet gama e dialogut dhe përforcohen pjesët që janë të vështira të kuptohen nga të moshuarit.
<b>NIGHT:</b> Tingulli del me volum të ulët me humbje minimale të besnikërisë dhe qartësisë së dialogut.	<b>ON</b>	Aktivizon funksionin e modalitetit të natës.
	<b>OFF</b>	Çaktivizon funksionin e modalitetit të natës.



\* DSEE do të thotë Digital Sound Enhancement Engine (Makinaria e përforcimit të tingullit dixhital) një teknologji për kompensimin e gamës së lartë të ngjeshjes dhe rikuperimit të tingujve të imët, e zhvilluar në mënyrë të pavarur nga Sony.

## Dëgjimi i tingujve nga pajisjet BLUETOOTH

### Kur regjistroni pajisje BLUETOOTH





#### Për të çiftuar sistemin me pajisjen (Çiftimi)

- 1 Shtypni butonin PAIRING.  
Llambushka  pulson me shpejtësi gjatë çiftimit të BLUETOOTH.
- 2 Vendosni pajisjen tuaj BLUETOOTH në modalitetin e çiftimit dhe zgjidhni „SONY:HT-CT370“.  
Nëse kërkohet një kod, vendosni „0000“.
- 3 Sigurohuni që të ndizet llambushka . (Është vendosur lidhja).


#### Sugjerim

Pasi të jetë vendosur lidhja BLUETOOTH, do të shfaqet një tregues që rekomandon se cili aplikacion për shkarkim do të shfaqet, sipas pajisjes me të cilën jeni lidhur. Pas udhëzimeve të shfaqura, mund të shkarkohet një aplikacion i quajtur „SongPal“, i cili do t'ju mundësojë të përdorni këtë sistem. Referojuni „Komandimi i marrësit me celular ose tabletë (SongPal)“ në Udhëzimet e përdorimit që keni marrë për detaje mbi „SongPal“.

#### Për të dëgjuar tingullin e pajisjeve të regjistruara

- 1 Shtypni butonin INPUT në mënyrë të përsëritur për të shfaqur „BT AU“.  
Llambushka  pulson gjatë përpjekjes për çiftimin e BLUETOOTH.
- 2 Në pajisjen BLUETOOTH, zgjidhni „SONY:HT-CT370“.
- 3 Sigurohuni që të ndizet llambushka . (Është vendosur lidhja).
- 4 Nisni riprodhimin e audios me softuerin muzikor në pajisjen e lidhur BLUETOOTH.

## Kur përdorni lidhjen me një prekje (NFC)



- 1 Shkarkoni, instaloni dhe nisni aplikacionin „NFC Easy Connect“ në telefonin tuaj smartphone.



- 2 Prekni shenjën N të altoparlantit horizontal me celularin smartphone.
- 3 Sigurohuni që të ndizet llambushka (blu). (Është vendosur lidhja).
  - Telefonat e përputhshëm  
telefonat smartphone, tabletat dhe lexuesit muzikorë me funksion të integruar NFC  
(OS: Android™ 2.3.3 ose version më i ri, përveç Android 3.x)







\* 4 4 8 8 9 6 9 2 1 \* (2)